

Feja

Zvicra është tradicionalisht një vend i krishterë. Sot jetojnë në Zvicër edhe shumë pjestarë që i përkasin një shoqërie tjetër fetare. Liria fetare është e garantuar dhe shkollat e shtetit për fe janë neutrale.

Feja dhe shteti

Zvicra është tradicionalisht e karakterizuar me fenë e krishterë. Qëndron në përgjegjësin e kantoneve, që t`i përcaktojnë marrdhëniet e fes me shtet. Në shumicën e kantoneve gjermanozviceran, si dhe në kantonin Basel-Landschaft, shoqëria fetare e krishterë është e pranuar si institucione publike-juridike (Kishat shtetërore, Landeskirchen). Kjo do të thotë, që shteti atyre ju bart disa të drejta. Konkretisht munden p.sh. prej pjestarëve të tyre të marrin tatim. Në kantonin Basel-Landschaft janë kishat römisch-katolike , ajo e reformuar dhe kristianekatolike si kisha shteti.

Shoqërit fetare në kantonin Basel-Landschaft (DE)

Pran shoqërive fetare (kishave shtetërore) zyrtarisht të pranuar ka në kantonin Basel-Landschaft edhe shoqëri tjera të shumta fetare me besime të ndryshme. Shumica e banoreve dhe banorëve të Basel-Landschaft i takojnë besimit të krishterë. Megjithatë, vitet e fundit është rritur edhe numri i anëtarëve të besimeve të tjera. Dhe përqindja e banorëve që nuk ndiejnë se i përkasin ndonjë besimi fetar po rritet gjithashtu

Liria fetare

Kushtetuta e Zvicrës garanton lirit fetare. Secili ka të drejtë, ta ketë një besim fetar, këtë besim ta shpreh dhe ta përhap. Askush nuk mund të detyrohet, të hyj në një shoqëri fetare apo të marr pjesë në veprimet e tyre. Personat mund të mblidhen për me festue ritualet fetare. Askush nuk guxon të diskriminohet për shkak të fesë apo besimit të tij.

Feja dhe shkolla

Shkolla e detyruar është për nga feja neutrale. Kjo nuk do të thotë, që temat religjioze nuk kanë vend në mësim. Dallimi bëhet në mes dy llojeve të mësimin për religjionin. Mësimi për fenë i kishave shtetërore dhe mësimi shkollor për besimin "Etika dhe Religjioni". Në këtë lëndë tematizohen pyetjet fetare dhe etike që u përkojnë tërë njerëzve. Në shkollën fillore të uët dhe në vitin e 1. të lartë është një lëndë e detyrueshme. Pjesëmarrja në mësimin rrëfyet fetar në kishat shtetërore është vullnetare. Për fëmijët me besim tjetër ofrojnë shoqërit fetare pjesërisht mundësi për mësim fetar jashtë shkollës.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/kantoni-basel-landschaft/feja